



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORI

Nr. 1407 Prot.

Vlorë më 20.07.2023

URDHËR
Nr. 75, Datë 20.07.2023
PËR

**PRANIMET E STUDENTËVE NË TË DY RAUNDET E APLIKIMIT, PËR
LLOGARITJEN E PIKËVE PËR ÇDO KONKURRENT DHE HARTIMIN E
LISTAVE TË KANDIDATËVE FITUESË NË BAZË TË PIKËVE TË
GRUMBULLUARA NË TË GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË
PARË TË STUDIMEVE QË OFROJNË DEPARTAMENTET E UV-SË PËR VITIN
AKADEMIK 2022-2023**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; si dhe në Urdhërin e Përbashkët nr. 10, datë 10.07.2023 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2023-2024";

URDHËROJ

1. Të pranohen në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë, në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë të studimeve që ofrojnë departamentet e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, kandidatët maturantë për studentë, të cilët kanë përfunduar me sukses ciklin e mesëm, të cilët plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar nga MAS për vitin akademik 2023-2024, si dhe të plotësojnë kriteret shtesë të pranimit të shpalluara nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, për çdo program studimi.
2. Pranë çdo departamenti të ngrihet një komision i përbërë nga përgjegjësi, tre anëtarë të zgjedhur prej departamentit dhe Sektori i IT-së, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore, z. Altin Mahilaj, z. Ismail Bitraj, znj. Ana Taushani dhe znj. Aulona Mustafaraj. Sektori i IT-së është në të gjitha komisionet e krijuara në departament. Funkzioni i komisioneve të jetë përllogaritja e pikëve për çdo kandidatë për student dhe hartimi i listës bazë të pikëve të grumbulluara (raundi i parë, raundi i dytë), referuar kritereve të shpalluara nga MAS dhe Sa për pranim në secilin program studimi. Komisioni i përllogaritjes së pikëve të kandidatëve dhe i hartimit të listave të fituesve kryesohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Në bazë të nenit 25, pika 8 e ligjit nr.80/2015, departamenti është përgjegjës për përzgjedhjen e studentëve fitues.
3. Çdo departament (komisioni përkatës) në bazë të kritereve të propozuara prej tij të miratuara nga SA si dhe kriterit të notës mesatare miratuar nga MAS për vitin



akademik 2023-2024, të shqyrtojë kërkesat dhe të kryejë procesin e përlogaritjes së pikëve për çdo konkurrent dhe renditjes së kandidatëve fitues në bazë të pikëve të grumbulluara.

4. Lista e studentëve fitues dhe procesverbali i plotë i të gjitha hallkave të procedurës së ndjekur për renditjen e tyre t'u përcillen drejtuesve të njësisë kryesore. Mbi bazën e dokumentacioneve të mësipërme Dekanët kryejnë miratimin e listave të studentëve fitues të hartuar në 4 (katër) kopje origjinale (hard copy) dhe elektronike të cilat administrohen nga: 1 (një) kopje nga kryesekretarja, 1 (një) kopje nga departamenti, 1 (një) kopje nga sekretaria mësimore dhe 1 (një) kopje i përcillet Rektorit. Nëse Dekanët nuk e gjejnë ligjore listën dhe procedurën e ndjekur, me vrejtjet konkrete përkatëse, i kthejnë ato përsëri për shqyrtim tek komisioni i renditjes së studentëve të ngritur pranë departamentit.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri Dekanët, Zëvendësdekanët, komisionet e përlogaritjeve të pikëve të çdo kandidati, Drejtuesit e Njësive Bazë dhe specialistët e Sektorit të IT-së të respektojnë afatet e vendimmarrjes respektive, raportimeve dhe proceduarave të parashikuara në Urdhërin e Përbashkët nr. 10, datë 10.07.2023 *“Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2023-2024”*.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Roland ZISI

